



---

**NJOFTIM PËR TË GJITHË KREDITORËT DHE PRONARËT E NDËRMARRJES**

**PRN211 "SirovinaBanat" Aseti në Obiliq**

Sirovina Banat - Zrenjanin

Industria për përpunimin dhe përfundimin e mbetjeve industriale

"Otpad" - Organizata Punuese për tregti dhe përpunim të mbetjeve industrial

me përgjegjësi të plotë - Zrenjan

Në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe nenit 7 të Shtojcës të këtij ligji, **NJOFTOHENI** se Likuidimi i Ndërmarrjes së lartpërmendur ka filluar me datë 14 dhjetor 2022 në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të datës 30 nëntor 2022.

**Çdo person i cili pretendon se ka të drejtë kërkesë dhe/apo interes ndaj kësaj ndërmarrjeje apo aseti të ndërmarrjes duhet të parashtrorë Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit sipas nenit 7 dhe nenit 23 të Shtojcës të Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në.**

**Afati për parashtrimin e kërkesave kreditore fillon me datë 19 dhjetor 2022 dhe përfundon me datë 2 shkurt 2023 në orën 16:00.**

**Ftoheni që të parashtroni Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit pavarësisht nëse më herët mund ta keni informuar Agjencinë Kosovare të Privatizimit apo pararendësin e saj. Nëse nuk parashtroni Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit brenda afatit kohor të lartë cekur, pretendimet tuaja do të refuzohen si të papranueshme bazuar në nenin 35 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në. Mosdorëzimi i dokumentacionit në mbështetje të kërkesës tuaj apo mosplotësimi i rregullt i formularëve, gjithashtu do të rezultojë në refuzimin e pretendimeve tuaja.**

**Formularët për Dëshminë e Kërkesës si dhe Dëshminë e Interesit mund të merren në të gjitha zyrat e AKP-së dhe duhet të dorëzohen në Zyrën Rajonale të AKP-së çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në ora 14:00 në adresën si më poshtë.**

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**  
**Zyra Rajonale në Prishtinë**  
**Rr. Dritan Hoxha, nr. 55, Lakrishtë**  
**10 000, Prishtinë**  
**Telefoni: +383 (38) 500 400**  
**Fax: +381 (38) 248 076**

Formularët për parashtrim të Dëshmisë së Kërkesës dhe Dëshmisë së Interesit gjithashtu mund të shkarkohen edhe nga faja e internetit të AKP-së në adresën [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org). Për udhëzime se si të plotësohen dhe dorëzohen këta formularë referohuni tek seksioni **"Formularët-Udhëzime për plotësim"**. Formularët e dorëzuar përmes postës elektronike nuk do të pranohen.